



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 17.12.2018

Dokument parlamentar

R A P O R T

PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE NË VENDIMIN E KUVENDIT NR.43/2017, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE ORGANIKËS TË AUTORITETIT TË KONKURRENCËS”

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 17.12.2018 shqyrtoi kërkesën e Autoritetit të Konkurrencës për miratimin e shtesës prej 3 punonjësish “inspektorë” të kategorisë III–a, në strukturën dhe organikën e këtij institucioni, kërkesë kjo e ardhur me shkresën nr.prot 3677, datë 21.11.2018.

Në mbledhjen e Komisionit ishte e pranishme për t’iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve Kryetarja e Autoritetit të Konkurrencës znj.Juliana Latifi si dhe përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Propozimi i Autoritetit të Konkurrencës konsiston në shtimin në strukturë të tre pozicioneve “Inspektor”, të kategorisë III- a, në drejtoritë teknike të këtij insitucioni dhe konkretisht në Drejtorinë e Mbikqyrjes së Tregjeve Prodhuese, Drejtorinë e Mbikqyrjes së Tregjeve të Shërbimit/ Jo Prodhuese dhe Drejtorinë e Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve. Shtesat e propozuara përlllogariten të kenë një efekt financiar prej 3,7 milion lekësh.

Gjithashtu, në zbatim të nenit 9, pika 2 të ligjit nr.9584 datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj” është marrë miratimi për këtë ndryshim nga Departamenti i Administratës Publike. Ndërsa Ministria e Financave dhe Ekonomisë është shprehur se do ta vlerësojë strukturën e propozuar vetëm pas hyrjes në fuqi të ligjit për buxhetin e vitit 2019.

Megjithatë, duke pasur parasysh se shtesa prej 3 punonjësish nevojitet për të përballuar aktivitetin në rritje dhe është në funksion të forcimit të kapaciteteve institucionale të Autoritetit të Konkurrencës, në përputhje me rekomandimet e rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë dhe të Raporteve të Progresit të Komisionit European, Komisioni i Ekonomisë dhe Financave e miratoi kërkesën e këtij institucioni me votat pro të të gjithë anëtarëve të pranishëm në mbledhje, me propozimin për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë që shtesës prej 3 punonjësish ta reflektojë në ndryshimet që do t'i bëhen ligjit nr.99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”.

KRYETARI

Erjon BRAÇE